



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 21/2010

Prishtinë më 25.05.2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Zef Morina,
Fatmir Rexhepi dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Mursel Haljilji, Qamile Morina, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari dhe
Nerxhivane Dauti.

Pjesëmarrës të tjerë: Lebibe Haliti – MTI, Lumnije Murati – ZPRK, Besnik Ramadanaj
– KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të 18. 05. 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit final i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara nr. L-165,
4. Shqyrtimi i Raportit final i Projektligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik nr. L-166,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181,
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 18. 05. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 18. 05. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit final i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara nr. L-165

Kryetarja – Theksoi se Raporti me amendamente i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara nr. L-165 pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga komisionet kryesore duhet të miratohet dhe të procedohet në seancë plenare për lexim të dytë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara nr. L-165

4. Shqyrtimi i Raportit final i Projektligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik nr. L-166

Kryetarja – Theksoi se Raporti me amendamente i Projektligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik nr. L-166, pas kthimit pa ndonjë vërejtje nga komisionet kryesore duhet të miratohet dhe të procedohet në seancë plenare për lexim të dytë.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Projektligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik nr. L-166

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L-181

Kryetarja – Theksoi se për këtë Projektligj ka qenë raportuese Nerxhivane Dauti, mirëpo në mungesë të saj e prezantoi vetë Raportin më Propozimamendamente, si vijon: Amendamenti 1 ndryshon titullin e Projektligjit; Amendamenti 2, ndërhyrje te

përkufizimet e nenit 1; Amendamenti 3, riformulon paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.1; Amendamenti 4 ndërhyt në nenin 7, ku pas paragrafit 3, shtohen paragrafët 4 dhe 5; Amendamenti 5, teksti i kapitujve II dhe IV i ndërrojnë vendet dhe paragrafi 1 i nenit 9 hiqet; Amendamenti 6, ndryshohet neni 11; Amendamenti 7, plotësohet paragrafi 1 i nenit 12; Amendamenti 8, ndërhyt te neni 13, përkatësisht plotësohen paragrafët 2 dhe 5, po ashtu shtohet paragrafi i ri 6; Amendamenti 9, ndryshohet neni 14; Amendamenti 10, plotësohet paragrafi 6 i nenit 18; Amendamenti 11, ndërhyt në paragrafin 1 të nenit 22; Amendamenti 12, ndryshohet paragrafi 2 i nenit 24; Amendamenti 13, ndryshohet neni 25; Amendamenti 14, ndryshohet neni 26; Amendamenti 15, ndryshohet paragrafi 1 i nenit 27; Amendamenti 16, plotësohet paragrafi 1 i nenit 35.

Amendamenti 5

Zef Morina – Theksoi se nëse Inspektorati do të shndërrohet në Agjenci do të ketë implikime buxhetore dhe ishte kundër këtij opsioni.

Ethem Çeku – Kërkoi që të fuqizohet inspektorati në nivel të Departamentit.

Lebibe Haliti (MTI) - Mbrojti propozimin që e ka hartuar MTI në Projektligj, sipas nenit 8.

Ibrahim Krasniqi, (konsulent) – Sqaroi që Inspektorati i Tregut duhet të jetë në nivel të Agjencisë, sepse aty ekziston një staf dhe një organogram që funksionon dhe nuk paraqet kurrfarë implikimeve buxhetore.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Amendamenti 8

Ethem Çeku – Theksoi se ky afat prej 30 ditësh si ai prej 15 ditësh i propozuar me amendament, është mjaft i gjatë dhe pengon zhvillimin ekonomik, sepse regresion biznesin.

Lebibe Haliti, (MTI) - Mbrojti propozimin që e ka hartuar MTI në Projektligj, që afati të jetë prej 15 ditësh dhe shtoi se ky paragraf nuk ka të bëjë me pezullimin e përkohshëm.

Zef Morina – Theksoi kur të vendoset afati i gjatë ka mundësi që të neglizhohet puna e inspektorit dhe propozoi të jetë nga 5 deri 15 ditë.

Fatmir Rexhepi – Theksoi se mbi një javë është tepër dhe propozoi 5 ditë punë të jetë afati për pezullimin e përkohshëm.

Kryetarja – Propozoi që ky afat të jetë nga 3 deri 10 ditë.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në

takimin e radhës.

Amendamenti 9

Ibrahim Krasniqi, (konsulent) – Sqaroi së në Projektligj është përcaktuar një vijë vertikale e përgjegjësisë nga inspektori drejtpërdrejt llogaridhënia te drejtori, gjë për të cilën nuk u pajtua dhe përkrahu amendamentin, sepse në amendament përcaktohet më qartë se inspektori e informon përgjegjësën e tij drejtpërdrejt që e mbikëqyrë punën e tij, e jo drejtorin.

Lebibe Haliti, (MTI) - E mbrojti propozimin që e ka hartuar MTI në Projektligj, që përgjegjësia të shkojë në formë vertikale drejtpërdrejt nga inspektori te drejtori.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Amendamenti 13

Ethem Çeku – Theksoi se nuk pajtohet me paragrafin 3, të nenit 25 që vendimin ta lëshojë inspektori prej afatit prej tetë ditësh, sepse është tepër i gjatë.

Zef Morina – U pajtua me qëndrimin e z. Çeku dhe shtoi se do të mjaftonte një afat më i shkurtër.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Amendamenti 14

Ethem Çeku – Nuk u pajtua me afatin kohor për lejimin e ankesës kundër vendimit të Inspektoratit.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Amendamenti 15

Zef Morina – U pajtua që detyrat e përcaktuara nga neni 27, të përcaktuara në P/Ligj janë të qarta dhe nuk ka pasur nevojë të amendamentohet.

Ethem Çeku – Theksoi se i është dhënë hapësirë e madhe inspektorit në ndërmarrjen e masave për ekzekutimin e veprimeve.

Ibrahim Krasniqi, (konsulent) – Shtoi që në amendament të hiqet fjala e “pashtyshme” dhe në vend të saj të jetë e “menjëhershme”.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Amendamenti 16

Ethem Çeku – Nuk u pajtua me shumën e caktuar të ndëshkimit me gjobë dhe kërkoi që të shikohet më saktë vënia e gjobave te bizneset e vogla dhe të mëdha.

Pas debatit Komisioni vendosi që kjo çështje të mbetet e hapur dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Konkluzion

- I. Miratohen Propozimamendamentet e grupit punues,*
- II. Për çështjet e hapura në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e MT I- së dhe kryeinspektori për sqarim të mëtutjeshëm.*

6. Të ndryshme

Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që për rendin e ditës në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Raporti vjetor i ART- së për vitin 2009 dhe shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese nr. L -181.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë

Konkluzion

Në mbledhjen e radhës rendi i ditës të jetë më këtë përmbajtje: Shqyrtimi i Raportit vjetor i ART-së për vitin 2009.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 30

E përgatiti:

Njësia e Mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani